

**Aroma e suksesit në biznes përcjell rrugën e shtruar me angazhim**

FAQE 2

**Kërpudhat e Kosovës udhëtojnë nëpër botë**

FAQE 2

**Shtegu i aventurës të sjell në Kosovë**

FAQE 2

# 2017 DHJETOR Buletini.

PROMOVIMI I PUNËSIMIT NË SEKTORIN PRIVAT

Në foton e mëposhtme: Shtegu i aventurës të sjell në Kosovë. Më gjerësisht në faqen 3.



## Vazhdojmë përpara!

Qëllimi kryesor i projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) është të rrisë punësimin në Kosovë, përmes përmirësimit të efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit privat.

Përmes aktiviteteve strategjike përgjatë Fazës I (2014 – 2017) në dy sektorët në fokus: përpunimi i ushqimit dhe turizmi, PPSE i ka tejkaluar pritshmëritë e projektit. Në total u krijuan 850 vende pune me orar të plotë, rritje e të ardhurave shtesë neto në €2 milionë dhe 1,000 ndërmarrje të vogla dhe të mesme që kanë përfituar nga projektit.

Në sektorin e përpunimit të ushqimit, PPSE ka bashkëpunuar me fermerë dhe kompani në një sërë sektorësh të intervenimeve, duke u fokusuar kryesisht tek prezantimi i varieteteve të reja industriale hibride dhe bimëve aromatike e mjekësore, përmirësimi i kapaciteteve të kultivimit, grumbullimit dhe përpunimit, standardet dhe cilësia e produkteve, pjesëmarrja në

panaire ndërkombëtare dhe identifikimi i tregjeve të reja, që kanë rezultuar në tërësi në kohezion të prodhimit dhe përpunimit në sektorin e fruta-perimeve.

Angazhimi i PPSE-së në sektorin e turizmit është fokusuar kryesisht tek promovimi i Kosovës si destinacion i turizmit të aventurës dhe tek zhvillimi i produkteve të reja. Transformimi që ka ndodhur gjatë tre viteve të fundit në industrinë e re të turizmit drejt një sektori me rezultate dhe me më shumë potencial pasqyrohet nga produktet e reja që janë zhvilluar dhe lansuar me sukses në treg si dhe nga mbështetja e kompanive për të marrë pjesë në panairë ndërkombëtare.

Kompanitë kanë marrë mbështetje edhe përmes mekanizmit të Fondit të Mundësive. Gjatë Fazës I janë investuar rreth €800,000 në 14 projekte. Nga sektori privat janë bashkë-investuar rreth €1,700,000. Mbështetje shtesë është ofruar përmes aktiviteteve dhe

trajnimeve për qeverisje të sektorit privat dhe qeverisje korporative, apo nismave për financim në bazë të kontratës dhe avokimit me sektorin publik. Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit privat përmirëson punësimin e grave dhe minoriteteve dhe PPSE i ka adresuar këto në të gjitha aktivitetet e veta.

Me 13 dhjetor 2017, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës Bajram Hasani dhe Drejtori i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë Patrick Etienne nënkruan marrëveshjen që siguron vazhdimin e mbështetjes së Qeverisë Zvicerane për krijim të vendeve të punës në sektorin privat në Kosovë. Faza II e PPSE-së zgjat nga nëntori 2017 – nëntor 2021, me një buxhet prej rreth 7 milionë franga zvicerane. Fushat e intervenimit në fokus janë në dy sektorë: ushqimi dhe përbërësit natyralë dhe turizmi.

Presim me kënaqësi të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë partnerët!

# INFORMATA KRYESORE NGA PUNA JONË

## Kërpudhat e Kosovës udhëtojnë nëpër botë

■ Fatmir Krasniqi, pronar i kompanisë FUNGO FF beson se produktet pyjore jo-drusore mund të jenë një bazë e mirë për zhvillimin e ekonomisë në Kosovë. Në të vërtetë, kompania e tij po e realizon me sukses pjesën e vet. Tashmë, produktet e FUNGO FF eksportohen në Zvicër, Itali, Gjermani, Holandë, Mal të Zi, Maqedoni, Rumani, Lituani dhe SHBA. Në vitin 2016, këto produkte u pritën shumë mirë në panairin

Slow Food në Zvicër. FUNGO FF e ka diversifikuar edhe më tej ofertën duke ndryshuar receptat tradicionale, p.sh. ajvari me kërpudha. Kërpudhat e tharra të bluara që përdoren si erë-

za apo fruta pylli të egra të ngrira janë produkte të reja që i janë shtuar listës së produkteve. Avancimi i pandërprerë i teknologjisë dhe proceseve është me rëndësi kyçe për të ruajtur përparësinë konkurruese. Me mbështetje nga PPSE, FUNGO FF ka siguruar pajisje të reja që garantojnë cilësinë e produkteve të paketuara. Përmes kësaj mbështetjeje, kompania ka krijuar në total rreth 60 vende të reja puna me orar të plotë dhe sezonale. Në fakt, kompania punon me një rrjet të gjerë të grumbulluesve nga e gjithë Kosova, duke angazhuar kështu mbi 1,000 individë. Dyzetë nga punëtorët aktualë të kompanisë vijnë nga komuniteti rom i zonës. Kjo është mundësi për ta për një jetë të dinjitetshme. Për të mësuar më shumë rreth FUNGO FF shikoni këtë [video](#)

Fatmir Krasniqi,  
pronar i kompanisë  
FUNGO FF



Kompania ofron përzgjedhje të pasur të çajrave bimorë, produkteve bimore për jetesë të shëndetshme, si uthull molle apo kremra bimorë të bërë në shtëpi.



## Aroma e suksesit në biznes përcjell rrugën e shtruar me angazhim

■ Ajo ia nisi punës 9 vjet më parë, me 10 pako me hithra të freskëta të grira që u shitën në një panair. Sot, Havushe Bajrami udhëheq kompaninë 99 LULE, një biznes i vogël që grumbullon, than dhe përpunon bimë aromatike dhe mjekësore, dhuratë nga natyra për ne. Kompania ofron përzgjedhje të pasur të çajrave bimorë, produkteve bimore për jetesë të shëndetshme, si uthull molle apo kremra bimorë të bërë në shtëpi. Ishte koha e duhur që biznesi i Havushes të linte pas cilësorin “i vogël” dhe të synonte më lart. Me mbështetje nga PPSE, Havushe themeloi një rrjet me 15 gra fermere, të cilat u kontraktuan për të kultivuar sherbelë dhe kalendulë për nevoja të përpunimit nga 99 LULE. Në kuadër të mbështetjes u ofruan inpute (fidanë dhe sisteme ujitjeje) dhe këshilla nga agronomja. Po ashtu, Havushja organizoi një sërë ditësh të hapura për të ndarë njohuritë dhe praktikatat me fermerët të tjerë dhe palë të interesuara. Gjithashtu, PPSE e vuri




Havushe Bajrami, 99 LULE

Havushen në lidhje me një kompani të specializuar për studime të tregut që ta mbështeste 99 LULE të përmirësojë brendin dhe konkurrueshmërinë, të ketë një strategji të qartë për diversifikimin dhe për të eksploruar mundësi të tjera në treg. Havushja thotë “Kjo bën të mundur rritjen dhe të ardhmen tonë”. Për të mësuar më shumë rreth historisë së Havushes, shikojeni këtë [video](#)



# Shtegu i aventurës të sjell në Kosovë

■ Të bëhesh pjesë e aventurës dhe argëtimit në natyrë është më e lehtë se kurrë për turistët ndërkombëtarë që zgjedhin Kosovën si destinacionin e tyre, apo për vizitorët vendorë që duan të eksplorojnë vendin e tyre. Aktivitete në natyrë të llojeve dhe sfidave të ndryshme si ngjitja në male, çiklizmi malor, eksplorimi i shpellave, skijimi natën, joga dhe kamping, shëtitje me kajake, ngjitja, Zipline, Via Ferrata apo Parku i Aventurës dhe shumë me tepër, po lulëzojnë në Kosovë. Vizioni i PPSE-së për ndryshime në sektorin e turizmit përfshin zhvillimin e produkteve dhe aktiviteteve të reja, të shtytura nga inovacioni. Gjatë Fazës I, intervenimet në sektorin e turizmit u përqendruan kryesisht në Kosovën Perëndimore, si rajon që ofron shumë mundësi për të zhvilluar aktivitete në natyrë dhe të aventurës. Rezultatet janë të prekshme: produkte të reja të turizmit, intensifikim i promovimit ndërkombëtar të turizmit dhe lidhje të reja biznesore që kanë përmirësuar dukshëm ofertën turistike të Kosovës. Numri i turistëve dhe i qëndrimeve është rritur me 75%, duke rezultuar në vende pune dhe mundësi të reja tregu, që të dyja këto mjete për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Çka është më



e rëndësishmja, Kosova po lë shenjë e vet si një destinacion për shpirtrat që kërkojnë aventurën. Ne hartuam një listë të disa prej aktiviteteve të zhvilluara me mbështetje nga PPSE për entuziastët e aventurës dhe natyrës. Listen e gjeni [këtu](#)

## Aty ku aventura takohet me pamje mahnitëse

PARKU I AVENTURËS ndodhet në majë të një kodre në Pejë dhe ofron përvojë absolute të aventurës në natyrë dhe adrenalinës në rreth 900 metra mbi lartësinë mbidetare. Atje, vizitorët mund të shijojnë natyrën përmes aktiviteteve të shumta argëtuese si kalërimi, ecja mbi litarë e platforma ajrore në nivele të ndryshme të vështirësisë, apo ngjitja nëpër shkallë-litarë. PARKU I AVENTURËS është produkt unik i Kosovës dhe rajonit dhe brenda pak kohësh është shndërruar në një nga destinacionet kryesore në vend, ku tërheq vizitorët të moshave të ndryshme. Si produkt që solli novacion në sektorin e turizmit, ai ka thyer akullin për ide të tjera inovative nga ky sektor. Projekti i PARKUT TË AVENTURËS u mbështet nga Komuna e Pejës dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë përmes projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat. Ai u ndërtua me ekspertizën e një kompanie çeke që është e specializuar për ndërtim të parqeve të aventurës në natyrë, një fakt më shumë se është vend i sigurtë për të gjithë. Tani, PARKU I AVENTURËS pasuron ofertën turistike në këtë qytet dhe në Kosovë, duke tërhequr më shumë vizitorë. Për më tepër, është argëtues, i sigurtë dhe pamja nga sipër Luhajës Gjigande është mahnitëse. Për më shumë informacion shikoni këtë [video](#)

## A E KENI DITUR SE?

A

**Demonstrimi në fermë** i mbjelljes dhe përpunimit të varieteteve industriale të perimeve është një mjet shumë i mirë që fermerët dhe përpunuesit të jenë vazhdimisht në hap me informatat e duhura dhe të shkëmbejnë përvoja. PPSE ka bashkëpunuar me AGROCELINËN dhe fermerë nëpër Kosovë, të cilët kanë organizuar një sërë ditësh të hapura fushore për të demonstruar teknikat dhe teknologjitë e avancuara që fermerët mund të përdorin. Ditët e hapura po ashtu kanë bërë të mundur promovimin e praktikave të mira bujqësore dhe kontratat në bujqësi ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i varieteteve të reja dhe përmirësimi i cilësisë dhe rendimentit, që përkthehen në më shumë përfitime dhe vende të reja pune.

B

**Produktet nga hikrra** janë të shijshme, të shëndetshme dhe tani, më të lehta për t'u gjendur. Kompania TRBOLJEVAC në Leposaviq e kultivon këtë bimë. Pastaj, ata e përpunojnë dhe pjekin shumë lloje të produkteve joindustriale. PPSE e ka mbështetur kompaninë që të shfrytëzojë tërësisht kapacitetet përpunuese për hikrrë dhe të përballojnë kërkesën në rritje. Në të vërtetë, furra TRBOLJEVAC po sjell ndryshim pozitiv në zonë, pasi më shumë fermerë po kultivojnë hikrrën në mënyrë më të organizuar.

C

**Oferta turistike e Kosovës** ka arritur në tregun japonez. Në shtator 2017, tre operatorë turistikë nga Kosova: ALTA VIA, FIBULA dhe AIRTOUR dhe Shoqata e Turizmit Alternativ të Kosovës ekspozuan në panairin vjetor Tourism Expo Japan, një nga panairët më të mëdhenj botërorë për promovim të turizmit. "Turizmi është mënyrë efektive për të promovuar më shumë bashkëpunim dhe për të tërhequr investime" tha Leon Malazogu, Ambasador i Republikës së Kosovës në Tokio. Me mbështetje të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës dhe Turkish Airlines, në nëntor 2017, një grup i gazetarëve japonezë vizitoi Kosovën për ta zbuluar këtë destinacion të ri për turistët potencialë nga Japonia.

D

**Në maj 2017, një grup prej rreth 20 operatorësh turistikë** dhe gazetarësh nga Ballkani përjetuan produkte të ndryshme turistike si: ecja në mal, çiklizmi malor, Via Ferrata, Zipline dhe paragliding në Zubin Potok, në kuadër të një udhëtimi familjarizues të organizuar nga InTER. Qëllimi ishte të rriten njohuritë për ofertën turistike në përgjithësi në pjesën veriore të Kosovës dhe për ta promovuar këtë destinacion. PPSE organizoi disa udhëtime familjarizuese në bashkëpunim me organizatat lokale për të promovuar Kosovën si një destinacion të turizmit në natyrë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me akterë rajonalë të turizmit.

Numri i turistëve dhe i qëndrimeve është rritur me 75%, duke rezultuar në vende pune dhe mundësi të reja tregu



# MODELI PËR NDRYSHIM



*"Dua të them që jam shumë e lumtur pasi që tani jo vetëm që di si të përgatisë bukën dhe si ta shes, por nga ky trajnim mësova edhe se si të prezantoj kompaninë time, si të punësoj punëtorë të ri dhe si të sillem si një ndërmarrëse."*

FARMA TRBOLJEVAC  
Jadranka Trboljevac

## Rishikim i organizimit të brendshëm të kompanive

■ Përvoja dhe hulumtimet e PPSE-së tregojnë se që NMV-të të zhvillohen mbi themele të forta, është me shumë rëndësi që ato të vënë në përdorim organizimin e brendshëm të kompanisë dhe të përdorin praktika të mira të qeverisjes korporative.

Përdorimi i këtyre praktikave është me rëndësi kyçe për zgjerimin dhe krijimin e mundësive të reja për punësim. Një nga intervenimet e PPSE-së në zhvillimin dhe qeverisjen e sektorit privat ka qenë përkrahja e ofruar për NMV-të, kryesisht nga sektorët e përpunimit të ushqimit dhe turizmit, që të përmirësojnë organizimin e tyre të brendshëm, në mënyrë që bëjnë kapërcimin në nivele më të larta të performancës dhe zgjerimit. Në partneritet me RECURA-n,

u hartua një program për nevoja të secilës NMV në fushën e trajnimit për organizimin e brendshëm të kompanive dhe qeverisjes korporative për drejtuesit ekzekutivë, pronarët dhe menaxherë, për t'u ndjekur nga këshillim në vendin e punës.

Tani, programi mund të shërbejë si referencë dhe kornizë për të kuptuarit më të thellë të praktikave të qeverisjes korporative dhe organizimit më të mirë të brendshëm të kompanive.

Efektet e këtij programi shkojnë përtej seancave që u mbajtën. NMV-të që ishin pjesë e programit në vazhdimësi po vënë në zbatim gjithnjë e më shumë praktikat e mira të organizimit të brendshëm, ndërkohë që kërkesa për shërbime të këtij lloji po rritet.

## Të flasim për të drejta pronësore të barabarta

■ Për të transformuar normat dhe praktikatat që ndërlidhen me të drejtën pronësore të grave nevojitet të rritet vetëdijësimi i burrave dhe grave. Këtu hyn dhe nevoja për të edukuar burrat, djemtë, gratë dhe vajzat për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të grave dhe për të mirat që kjo gje u sjell familjeve dhe shoqërisë në tërësi.

"Hisja" është një shfaqje e formatit të teatrit forum që kërkon të rrisë vetëdijësimin për barazinë gjinore në raste trashëgimore dhe për të promovuar regjistrimin e përbashkët të pronës nga burrat dhe gratë.

Shfaqja ishte pjesë e projektit "Patundshmëria dhe Barazia Gjinore" nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës në bashkëpunim me Qendrën për Art dhe Komunitet - ARTPOLIS, që u mbështet nga PPSE. Shfaqjen e plotë mund ta shihni [këtu](#). Pas shfaqjes, audienca u bë pjesë e një diskutimi shumë aktiv. Shihni këtu [videon](#) për të dëgjuar mendimet dhe komentet e tyre.



"Hisja" është një shfaqje e formatit të teatrit forum që kërkon të rrisë vetëdijësimin për barazinë gjinore në raste trashëgimore dhe për të promovuar regjistrimin e përbashkët të pronës nga burrat dhe gratë.

Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Prishtinë, Kosovo  
Tel: +381(0)38220403  
email: [ppseinfo@swisscontact.org](mailto:ppseinfo@swisscontact.org)  
website: [www.ppse-kosovo.org](http://www.ppse-kosovo.org) and  
[www.swisscontact.org/kosovo](http://www.swisscontact.org/kosovo)  
[www.facebook.com/ppse.kosovo](https://www.facebook.com/ppse.kosovo)

### Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.